

#LevizAlbania




DEDIKUAR DEMOKRACISË VENDORE

RAPORT: “VLERËSIMI I PËRVOJAVE”

Mbështetja e LevizAlbania për individët dhe grupet informale nëpërmjet skemave të granteve dhe mentorimit”



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Aiencia Zvicerane për Zhvillim

Zbatuar nga



Hartues: Floreta Zhulali

LevizAlbania dëshiron të shprehë falenderimet për kontributin e përfituesve të granteve, të cilët ndanë mendimet dhe kohën e tyre, për hartimin e këtij Raporti.

Falenderim për kolegët e LevizAlbani për kontributin në hartimin e këtij Raporti:

Përgjegjëse:

Anahí Martínez – Manaxher për Monitorimin, Vlerësimin dhe Shoqërinë Civile

Rishikimi programatik:

Ertón Kashta – Drejtor Ekzekutiv

Eriona Kaceli – Manaxhere e Granteve Individuale

Iris Panariti – Menaxhere e Programit të Granteve

Rezar Balla – Ekspert i Medias dhe Komunikimit

© LevizAlbania Nëntor 2021

Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Parakusht

Mendimet dhe rezultatet e shprehura në këtë punim janë të autorit/autorëve dhe jo detyrimisht përputhen me qëndrimet dhe mendimet e donatorit, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SDC.

**Floreta Zhulali
NËNTOR 2021**

TABELA E PËRMBAJTJES

SHKURTESAT	4
PËRMbledhje Ekzekutive	5
HYRJE	7
HISTORIKU	7
Fusha e Punës për Vlerësim	9
PËRMbledhje e Metodave	9
Nivelet e Analizës	10
Korniza e Projektit dhe e Vlerësimit	10
PERSONAZHET	11
PERSONAZHI 1	12
PERSONAZHI 2	14
PERSONAZHI 3	17
HARTA E PROCESIT DHE MUNDËSUESIT	20
KONTRIBUTI DREJT QËNDRUESHMËRISË	23
MËSIMET DHE VËZHGIMET	28
KATEGORITË E PRAKTIKËS	32
GJETJET DHE REKOMANDIMET	36
TË VAZHDOHET...	36
TË RISHIKOHET...	37
TË FILLOHET...	38
KOMENTE PËRFUNDIMTARE	39
REFERENCAT DHE BIBLIOGRAFIA	41

SHKURTESAT

LA	LevizAlbania
SDC	Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim
FAHP	Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë
PSHNZH	Partnerët Shqipër për Ndryshim dhe Zhvillim
CP	Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit
SHVSH	Shërbimet me Vlerë të Shtuar
OSHC-të	Organizatat e Shoqërisë Civile
NJQV	Njësia e Qeverisjes Vendore

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Rruga e gjatë e tranzicionit të Shqipërisë drejt një qeverisje të mirë, e udhëhequr nga parimet demokratike, vazhdon të japë rezultate të diskutueshme (Raporti i Rezultateve Tranzicionale të Shqipërisë 2018–2020, 3). Një debat i brendshëm politik mjaft konfliktual dhe një ekonomi e brishtë sjellin dobësi të tjera për një shoqëri tashmë të brishtë. Një nga efektet anësore, i cili u theksua më tej nga tërmeti shkatërrues dhe pandemia globale vitet e fundit, është niveli i paqëndrueshëm i besimit të qeverisja, qoftë kjo qendrore apo vendore (Besimi në Qeverisje 2020). Pavarësisht reformave të vazhdueshme, mbetet ende një rrugë e gjatë për t'u bërë në këtë fushë drejt arritjeve të rëndësishme. Megjithatë, ekziston një konsensus i gjerë se angazhimi i qytetarëve është çelësi për stimulimin e një pushteti të balancuar të autoritetit, i cili përfaqëson banorët e tij dhe interesat e tyre. Bazuar në historikun dhe kontekstin e sipërpërmendur, në vitin 2015, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC krijoi projektin LevizAlbania (LA) i cili zbatohet nga një Konsorcium Partnerësh tërësisht shqiptar. Qëllimi i referohet përfitimeve të popullsisë shqiptare nga një demokraci e përmirësuar në nivel vendor. Njëpërmjet një mekanizmi grantesh, LA-ja ka mbështetur aktorët qytetarë ekzistues dhe ata në zhvillim për paraqitjen e kërkesave përkatëse të komunitetit, duke ndjekur një qasje të orientuar drejt veprimit që jep rezultate të prekshme për qytetarët.

Njëpërmjet ndërhyrjes së saj novatore, e cila e zhvendos fokusin drejt anëtarëve më pak të shquar të shoqërisë civile, LA-ja ka ofruar mbështetje për 79 individë dhe grupe informale që përfshijnë pothuajse të gjithë territorin shqiptar. Si pjesë e përpjekjes së saj për të rritur në mënyrë të qëndrueshme angazhimin qytetar, LA-ja ofron mbështetje duke kontribuar në një cikël të plotë qytetarie aktive, nga “heroi social”¹ i sapo krijuar, te organizata e mirë formalizuar (OSHC).

Thirrjet për grante dhe proceset e saj transparente merren në konsideratë nga përfituesit dhe shtojnë besueshmërinë dhe integritetin.

LA-ja shpeshherë ka ritheksuar dhe pasuruar praktikën e saj për të rritur rezultatet dhe ndikimin e dëshiruar. Si rrjedhim, ky vlerësim është pjesë e ciklit të saj të të mësuarit dhe përmirësimit dhe njëpërmjet këtij vlerësimi synon të shqyrtojë në mënyrë specifike mënyrën se si dhe se ku mbështetja e dhënë ndaj individëve dhe grupeve informale kontribuon në rritjen e qëndrueshme të aktivizmit. Rezultatet tregojnë se në kushtet aktuale, kontributi i LA- së drejt aktivizmit të qëndrueshëm është për t'u lavdëruar, edhe pse rezultati mes grupeve të synuara nuk është i barabartë. Motivuesit dhe kufizimet kryesore zhvillohen nga karakteristikat dhe tiparet e formimit të individëve dhe grupeve informale, të cilat, së bashku me veçoritë e tjera të kontekstit, përcaktojnë efektivitetin e asaj që ofron LA-ja dhe shkallën e arritshme të qëndrueshmërisë.

¹ Koncepti i “heroit social” i referohet individit, kauza personale e të cilit arrin një audiencë më të madhe në një komunitet dhe karakteri dhe vlerat e të cilit i tërheqin të tjerët në një nivel më të lartë dhe më të zgjeruar se sa një problem i vetëm. “Heroi social” bëhet një pikë referimi dhe një figurë që ngjall respekt tek të tjerët (ndër të tjera) për shkak të integritetit, ndjeshmërisë së thellë dhe ndjenjës së objektivitetit dhe me kalimin e kohës, heroi social fiton baza të tjera morale, duke arritur si përfundim, të fitojë besimin e ndjekësve të tij/saj.

Mbështetja për zhvillimin e ideve dhe qasja e LA-së si platformë, vlerësohen shumë nga përfituesit e granteve si një ndikim real dhe praktik drejt ndërtimit të kapaciteteve, duke forcuar në këtë mënyrë besueshmërinë e aktorit civil dhe cilësinë e rezultateve të arritura në dobi të komunitetit. Po kështu, trajnimi rezultoi të jetë veçanërisht i rëndësishëm për individët, jo vetëm si përcjellje e njohurive, por edhe si nxitës emocional. Ky i fundit mbizotëron edhe me grupet informale, të cilët shprehin nevojën për një qasje më gjithëpërfshirëse dhe empatike. Së fundi, një nga gjetjet kryesore të ciklit të përmirësimit të LA-së i referohet një boshllëku të krijuar nga mungesa e një mekanizmi pasues, pas përfundimit të projekteve, i cili konsiderohet i domosdoshëm si nga individët, ashtu edhe nga grupet informale.

Mbështetja e përpjekjeve për të arritur rezultate përtej kohëzgjatjes së një projekti dhe adresimi i dështimeve të projektit si mjet për të trajtuar pengesat dhe mungesën e efikasitetit, në formën e një Thirrjeje plotësisht të dedikuar, do të ishte një kontribut i rëndësishëm nga LA-ja. Këto kanë mundësinë të rrisin ndjeshëm legjitimitetin, besueshmërinë dhe tërheqjen e aktorit civil. Më e rëndësishme nga të gjitha është që, përpjekje të tilla janë thelbësore për krijimin e agjentëve të ndryshimit dhe iniciativave me një efekt të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë e angazhimit.

HYRJE

HISTORIKU

LevizAlbania është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, i zbatuar nga një konsorcium i tre partnerëve shqiptarë, OSFA, Co-Plan dhe Partners Albania. Ky projekt synon të përmirësojë dhe forcojë qeverisjen demokratike vendore nëpërmjet skemave të granteve, si mekanizmi për të angazhuar dhe fuqizuar aktorët civilë në vend. Orientimi strategjik i LA-së drejt objektivit të mësipërm sjell dy qasje novatore: së pari, zbatimi paraprihet nga një vlerësim i plotë i nevojave të qytetarëve shqiptarë për një qeverisje vendore funksionale dhe bashkëpunuese; së dyti, grupet e synuara të skemave të granteve kanë përfshirë individë dhe grupe informale si aktorë të drejtpërdrejtë të vendimeve të NJQV-ve.

Qasjet novatore konsiderohen akoma më të rëndësishme pas reformës së re territoriale dhe administrative të zbatuar në vitin 2015. Më konkretisht, reforma përfshinte 4 objektiva strategjikë:

1. Përmirësimi i efektivitetit të përgjithshëm të strukturave të qeverisjes vendore;
2. Forcimi i financave vendore dhe rritja e autonomisë fiskale;
3. Nxitja e rritjes së qëndrueshme vendore;
4. Forcimi i qeverisjes së mirë vendore.

Ndërkohë që reforma ka parë rezultate të ndryshme në secilën prej 4 objektivave të përshkruar më sipër, çdo nivel performace varet nga kërkesë-oferta dhe nga qeverisja e mirë, si dhe nga efikasiteti i shërbimit.

Qasja e LA-së nga poshtë-lart brenda këtij konteksti, duke mbështetur angazhimin e drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe mentorimin e aktorëve të rinj të ndryshimit, është një lëvizje logjike drejt promovimit të një komuniteti të vetëdijshëm që kërkon efikasitet të shërbimeve publike dhe dhënien përparësi të nevojave të tyre më imediate nga NJQV-të.

Megjithatë, problemet që erdhën si rezultat i reformës territoriale administrative dhe reformës së decentralizimit u theksuan më tej nga një klimë politike e mbushur me ngjarje. Zgjedhjet vendore të vitit 2019, rezultuan në drejtimin e njësisive të vetqeverisjes vendore (NJQV-ve) në nivel vendi nga një parti e vetme politike, gjë që solli ndërlikime të mëtejshme për një qeverisje të mirë gjithëpërfshirëse dhe angazhim të demotivuar të qytetarëve. Mund të paraqesim si argument faktin se ndikimi reflektohet në rezultatet e sondazhit të opinionit të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM). Ekziston një rënie e menjëhershme e besimit të qytetarëve ndaj pushtetit vendor, nga 49% në vitin 2017, në 47% në vitin 2018 dhe 42% në dy vitet pasuese. Kjo reflektohet më tej në aspekte të tjera të angazhimit të qytetarëve të matur në sondazhin e IDM-së, të tilla si mundësitë e pjesëmarrjes në vendimet dhe proceset publike vendore dhe perceptimi i qytetarëve për dëgjesat publike vendore si ngjarje formale dhe jo gjithëpërfshirëse (Sondazhi i Opinionit të IDM-së: Besimi në Qeverisje 2020, 74-90)(Sondazhi i Opinionit të IDM-së: Besimi në Qeverisje 2020, 74-90).

Pandemia e Covid-19, e cila u shfaq gjatë tremujorit të parë të vitit 2020, imponoi një aspekt të ri të detyrave praktike dhe ngarkesës emocionale në mbarë botën, përfshirë Shqipërinë. Shoqëria civile në nivel vendor u mobilizua shpejt, megjithatë kalimi në një kulturë të re 'on-line' të zhvillimit të punës, të takimeve dhe organizimit ishte sfidues dhe përjashtoi ata aktorë dhe komunitete që nuk kishin infrastrukturën e duhur teknologjike dhe aksesin në rrjet. Për më tepër, Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) raportuan mungesën e koordinimit ndërmjet autoriteteve publike dhe palëve të tjera të interesuara, duke krijuar mangësi në administrimin e reagimit të përgjithshëm ndaj pandemisë (Roli i OSHC-ve dhe mediave në menaxhimin e krizave, 6-7).

Konteksti i mësipërm thekson në mënyrë të arsyeshme rëndësinë e qasjes bazë të LA-së me fokus individin, duke fuqizuar zërat individualë të komuniteteve në ngritjen e shqetësimeve dhe paraqitjen e kërkesave që ndikojnë në jetën e tyre të përditshme. Për më tepër, ndryshimet dhe inovacionet sociale ndodhin falë disa heronjve socialë, të cilët fitojnë besimin dhe me kalimin e kohës fitojnë legjitimitet dhe nivel 'përfaqësimi' brenda dhe jashtë komuniteteve të tyre (Projektimi, kur të gjithë projektojnë: hyrje në projektimin për inovacionin social, 62). Si rrjedhim, fuqizimi i individëve për këtë qëllim është hapi i parë racional drejt një shoqërie më aktive e më të vetëdijshme. Si pjesë e përpjekjeve të saj për të rritur angazhimin dhe aktivizmin qytetar, që nga fillimi i saj dhe deri në shkrimin e këtij raporti, LA-ja ka marrë mbi 2270 aplikime, 820 prej të cilave kanë ardhur nga individë dhe grupe informale.

Ata kanë paraqitur një gamë të gjerë idesh të rëndësishme dhe të prekshme për komunitetin, të cilat konfirmojnë rezultatet e përsëritura të sondazhit "Besimi në Qeverisje" të IDM-së, ku një në çdo dy shqiptarë është i interesuar të marrë pjesë aktivisht në procesin e vendim-marrjes vendore dhe mbi 71% mendojnë se kanë njohuri për vendimet e qeverisë (Besimi në Qeverisje 2020, 74-80). Numri i aplikimeve nga individë dhe grupe informale për 7 Thirrjet e LA-së dhe shtrirja e tyre gjeografike, rikonfirmojnë gjithashtu pranimin e qasjeve të reja për nxitjen e angazhimit të qytetarëve dhe qëndrimin unik të LA-së në këtë drejtim.

Nga ana tjetër, qëndrueshmëria e aktivizmit është një synim mjaft kompleks dhe kërkon që veprimi i vogël individual të qëndrojë, të rritet dhe të ushqehet më tej nga një mjedis i favorshëm në aspektin kulturor, social dhe ekonomik. Situata e cenueshme ekonomike, sociale dhe politike e Shqipërisë, veçanërisht pas efekteve katastrofike të tërmetit të fuqishëm në vitin 2019 dhe pandemisë së vazhdueshme globale që nga viti 2020, nuk favorizon qëndrueshmërinë e angazhimit të qytetarëve. Ndryshimet e rezultateve të sondazhit të IDM-së nga viti në vit në pothuajse të gjithë treguesit, që nga viti 2018 e në vazhdim, i vënë në dukje këto shqetësime. Megjithatë, LA-ja ka vazhduar përpjekjet e saj për qëllimin kryesor. Që nga viti 2015, përmes 7 Thirrjeve për Aplikime, ka ofruar grante dhe mbështetje për 79 individë dhe grupe informale përmes një procesi transparent dhe të hollësishëm, i cili është rihvilluar dhe përmirësuar vazhdimisht dhe ka përdorur një sërë instrumentesh si mentorim dhe rrjetëzimin.

Nëpërmjet Konsorciumit të Partnerëve, LA-ja ofron edhe Shërbime me Vlerë të Shtuar si ndihmë juridike falas (Klinika e Ligjit), akses transparent në financat vendore dhe shërbimet publike (Financatvendore.al dhe Portavendore.al), etj. Efektiviteti dhe kontributi i këtyre instrumenteve drejt objektivave të aktivizmit të qëndrueshëm do të jenë objekt i analizës në këtë vlerësim.

FUSHA E PUNËS PËR VLERËSIM

Qëllimi i kësaj analize është të kryejë hartimin dhe vlerësimin e përvojës në mbështetjen e individëve dhe grupeve informale nga LA-ja. Vlerësimi i përvojës do të synojë konsolidimin dhe shpërndarjen e njohurive mbi mënyrën se si dhe nëse mbështetja e ofruar deri tani për individët dhe grupet informale (nga LevizAlbania, por jo vetëm) arrin të rrisë në mënyrë të qëndrueshme nivelin e aktivizmit duke krijuar një numër më të madh qytetarësh aktivë.

PËRMBLEDHJA E METODAVE

Metodologjia për këtë raport përfshiu një seri seminaresh dhe diskutimesh në grup me LA-në, vëzhgime pjesëmarrëse, 15 intervista të detajuara gjysmë të strukturuar me përfituesit e granteve nga të gjitha Thirrjet, një anketë on-line për të gjithë individët dhe grupet informale të mbështetur nga LA-ja, bashkëbisedime me informatorë të tjerët kryesorë dhe rishikimin e literaturës përkatëse. Kjo e fundit përfshin artikuj, përshkrime, politika, sondazhe dhe

rishikim të literaturës që kanë të bëjnë me projektin, të cilat ndihmojnë në krijimin e bashkëbisedimeve përkatëse dhe nxjerrjen e mësimave prej tyre ose ndihmojnë në planifikim ku synohet arritja e perspektivave të palëve të ndryshme të interesit.

Për më tepër, për të hartuar vlerësimin e përvojës, është përdorur metoda Të menduarit mbi Projektimin e cila përqendrohet te "përdoruesi përfundimtar" (aktori civil në këtë rast) dhe për këtë arsye ajo nxjerr në pah dhe shqyrton në mënyrë specifike atë që e motivon, që e tërheq dhe rrjedhimisht ndryshon sjelljen e tyre duke paraqitur përcaktimin e problemit (angazhimin e qëndrueshëm). Si rrjedhim, kjo qasje ndihmon për të vënë në dukje elementet e qëndrueshmërisë, pasi bazohet pikërisht në shkëmbimet e mendimeve të grupit të synuar dhe mund të përdoret në mënyrë të përsëritur. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, Të menduarit mbi Projektimin përdoret në aspektin e përmirësimit, pasi e konsideron përvojën si një proces në zhvillim, rezultatet që nxirren prej tij nuk përcaktohen si të përhershme, por përdoren për të përforcuar dhe përmirësuar vazhdimisht ato elemente të vlefshëm që sjellin vlera dhe ndikimin e dëshiruar.

NIVELET E ANALIZËS

Sipas metodologjisë së përshkruar më sipër, në këtë dokument do të prezantohen nivelet e mëposhtme të analizës:

1. Personazhet², duke krijuar një përcaktim të qartë se kush është aktori civil, cilat janë karakteristikat e tyre, cilat janë nevojat e tyre të përbashkëta, çfarë vlerësojnë ata të vlefshme për veten dhe komunitetin dhe ku e shohin vlerën e nismës së tyre në rolin e 'heroit social'.

2. Një planifikim të procesit që detajon pikat kyçe të ndërveprimit midis LA-së dhe personave, çfarë ofrohet si mundësues dhe çfarë krijon vlerë potenciale për qëndrueshmëri.

3. Në bazë të përgjigjeve të marra nga intervistat dhe sondazhet, hartohet një dokument mbi vëzhgimet e të mësuarit, i cili përqendrohet në vlerësimin e përvojës që krijon kategori praktikash të dëshirueshme

KORNIZA E PROJEKTIT DHE E VLERËSIMIT

Përpara se të analizojmë në detaje vlerësimin e përvojës është e rëndësishme të keni parasysh kornizën analitike të përcaktuar që po përdoret në këtë rast. Figura I më poshtë, përcakton shpjegimin e mëposhtëm:

ose jo të dëshirueshme/ kufizuese. Kjo e fundit, zbaton ose zvogëlon respektivisht qëndrueshmërinë e angazhimit.

4. Për t'i kushtuar rëndësi përvojës, do të hartohet një tabelë me gjetjet dhe rekomandimet "Të vazhdosh", "Të rishikosh" dhe "Të fillohet".

5. 5 faktorët më të rëndësishëm të qëndrueshmërisë theksohen në komentet dhe konkluzionet përfundimtare, në bazë të mendimeve të dhëna nga përfituesit e intervistuar rreth procesit dhe projektimit të vlerës që LA-ja ofron përmes skemave të granteve dhe trajnimit për të përcaktuar përfundimisht aspektin ku LA-ja mund të luajë rol për rritjen e aktivizmit.

nëse dhe si aktivitetet dhe mekanizmat e ofruara nga LA-ja krijojnë aktorë qytetarë dhe iniciativa të reja/ të rikthyera, dhe nëse dhe si këto nga ana e tyre krijojnë një numër më të madh të qytetarëve aktivë si mjet për rritjen në mënyrë të qëndrueshme të nivelit të aktivizmit.

FIGURA I

QËLLIMI:

RITJA NË MËNYRË TË QËNDRUESHME E NIVELIT TË AKTIVIZMIT

AKTIVITETET/ MEKANIZMAT:

GRANTET, MENTORIMI, SHVSH-JA

Qëndrueshmëria e Aktivizmit mund të përkufizohet dhe matet në shumë mënyra, megjithatë për qëllimet e këtij vlerësimi, qëndrueshmëria e aktivizmit do t'i referohet: aftësisë për të krijuar dhe zhvilluar më tej aktorët civilë (individët dhe grupet informale);

PERSON-AZHET

Hartimi dhe vlerësimi i përvojës kërkon një kuptim të plotë të grupeve të synuara në studim, dhe konkretisht të individëve dhe grupeve informale që kanë marrë pjesë si përfitues të granteve. Theksi vihet në krijimin e prototipeve bazuar në atë pjesë të historikut të tyre që përcakton dhe formon nevojën dhe qëndrimin ndaj mbështetjes së ofruar nga LA-ja dhe nga instrumentet e tjera të mundshme, të ofruara nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të), duke pasur si qëllim përfundimtar arritjen e rezultateve të dëshiruara siç përshkruhet në Figurë I më lart. Këto prototipe përshkruhen si Personazhe. Individët e zgjedhur dhe grupet Informale që janë përzgjedhur, shërbejnë për të përcaktuar dhe përfaqësuar në mënyrë specifike Profilet më të

NDËRHJRJA:

KRIJIMI I NJË NUMRI TË LARTË TË QYTETARËVE AKTIVË

REZULTATET E DËSHIRUARA:

AKTIVISTËT E RINJ, GRUPET E REJA INFORMALE, AKTIVISTËT, SHKAQET DHE GRUPET INFORMALE TË QËNDRUESHME

aftësia për t'i dhënë zë kërkesave të nxitura nga komuniteti dhe për të mbështetur përpjekjet në trajtimin e këtyre kërkesave me qeverisjen vendore dhe institucionet e tjera; si dhe aftësinë për të rrjetëzuar dhe shumëfishuar energjitë e aktorëve civilë për të fituar vëmendje dhe mbështetje nga komuniteti.

përgjithshme të Personazheve siç paraqiten në tabelat e përfshira në këtë raport. Përshkrimet e hollësishme ndihmojnë për të kuptuar se si bëhen përgjithësimet, bazuar në përvojat reale dhe në historikun e tyre, por edhe të kontekstualizojnë veprimet dhe sjelljet. Një aspekt kyç i punës me Personazhet është përjetimi i përvojës së tyre në këndvështrimin e vetë Personazheve, pa paragjykime dhe nuk ka vend për veprime të drejta ose të gabuara. Kjo është arsyeja pse Profilet e Personazheve nga ana e tyre ndihmojnë për të vlerësuar në mënyrë të qartë përvojën dhe për të përcaktuar se ku krijohet vlera dhe/ose humbmet ajo ndërkohë që punojnë me idetë e projektit deri në zbatimin e tij dhe më gjerë. Në bazë të intervistave të detajuara me përfituesit e granteve u hartuan Personas-it e përshkruar më poshtë.

² Persona-t janë prototipe të përgjithshme, të identifikuar gjatë intervistave, që ndajnë nevojat dhe qëndrimet drejt një qëllimi të dëshiruar përfundimtar, që është aktivizmi i qëndrueshëm në këtë rast. Si rrjedhim, ata lejojnë grupimin e përfituesve të granteve bazuar në karakteristikat unike që i dallojnë ata nga grupet/ grupimet e tjera. Vlerësimi i përvojës brenda prototipit gjeneron njohuri të rëndësishme që pasqyrojnë atributet kolektive, të cilat rrjedhimisht formësojnë sjelljet.

PERSONAZHI 1



INDIVID I RI, ALBA³

Alba ka aplikuar për herë të parë si individ në Thirrjen e LA-së. Alba është e punësuar me kohë të plotë (jashtë OSHC-ve) dhe është shumë e përkushtuar në punën e saj të përditshme. Ajo shpesh flet me familjen dhe kolegët për çështje që mendon se janë dhe duhet të jenë të rëndësishme jo vetëm për veten, por edhe për një komunitet më të gjerë. Alba ka një lidhje të thellë emocionale me një problem që ajo mendon se nuk bazohet vetëm në përvojën e saj. Kjo lidhje emocionale e bën atë kategorike në mendimet e saj duke mbajtur një qëndrim të qartë. Ajo kërkon vëmendje dhe përfshirje nga grupe më të mëdha dhe ndërmerr hapa të vegjël drejt arritjes së qëllimeve të saj që kërkojnë pëlqimin e përgjithshëm dhe jo miratimin procedural. Alba është entuziaste, por ndonjëherë ka dyshime për rolin dhe fuqitë e saj. Ajo është shumë realiste se bota nuk do të ndryshojë brenda natës, por është e vendosur të luajë rolin e saj. Nuk ka ndonjë përvojë të rëndësishme me shoqërinë civile dhe menaxhimin e projekteve; prandaj, ajo e gjen veten të mbingarkuar me procedurat dhe kërkesat e menaxhimit të projektit. Si rezultat, Alba ka nevojë për shumë mbështetje dhe trajnim. Ajo nxitet shumë nga rezultatet e prekshme dhe e sheh këtë të fundit si një mënyrë për të fituar legjitimitet dhe besueshmëri brenda një grupi më të madh njerëzish me mendime të ngjashme, si dhe për të fituar një nivel bazë autoriteti me përfaqësuesit e qeverisë.

Ajo është shumë aktive në rrjetet sociale, por jo shumë e shkathët me mjetet dhe mediumet e tjera dixhitale.

Alba është e kufizuar në aktivitetet e saj nga puna me kohë të plotë dhe detyrimet familjare dhe ka nevojë për dashamirësinë dhe fleksibilitetin e bashkëpunëtorëve. Personaliteti dhe dobësitë e saj i japin asaj besueshmëri dhe e bëjnë atë shembull të një heroi social dhe jo thjesht një viktimë të padrejtësisë. Ajo është një figurë frymëzuese për shumë të tjerë brenda rrethit të saj shoqëror dhe profesional. Së fundi, Alba është shumë e vetëdijshme për aftësitë që zotëron dhe mangësitë e saj. Pikëpamjet e saj rreth kontributeve të LA-së dhe projektit në përgjithësi janë shumë praktike dhe të sakta. Ajo shqetësohet jo vetëm për arritjen e rezultateve, por edhe për ruajtjen e tyre me kalimin e kohës, pas përfundimit të projektit të saj. Kauza e saj shkon përtej kohëzgjatjes së projektit dhe asaj i duhet ende të punojë që njësia vendore të ndërmarrë veprime afatgjata. Ajo nuk e ka të mundur ta mbajë aktivizmin e saj për një kohë të gjatë, pa mbështetje financiare. Paga e saj shumë modeste si mësuese në një shkollë filllore mezi mjafton për të mbajtur familjen e saj të vogël. Një profil i përgjithshëm i Albës si individ, i cili po shfaqet si një aktor aktiv qytetar i quajtur Individ i Ri paraqitet në Tabelën 1 më poshtë.

PROFILI I PERSONAZHIT: INDIVID I RI

Individi i ri është dikush që bën përpjekjet e tij të para si anëtar aktiv i shoqërisë civile. Ata janë njerëz me njohuri shumë të mira profesionale dhe e ndjejnë si detyrim të flasin për çështje që vërtetë i shqetësojnë. Ata kanë një lidhje të fortë personale me një problem dhe kjo u jep atyre besueshmëri në komunitetin ose grupin e tyre të interesit. Ata bëhen heroi social i komunitetit lokal, mendimi i të cilit dëgjohet; duke qenë të zotët në fitimin e ndjeshmërisë, ata sigurojnë mbështetje në mënyrë shumë të natyrshme, e cila sa vjen e rritet. Ata flasin vetëm për përvojën e tyre dhe kjo i bën ata shumë të motivuar dhe të vetëdijshëm, por gjithashtu shprehin nevojën për njohje dhe vetëpërbushja. Ajo që kërkojnë ka rëndësi për ata vetë, por shtrihet edhe përtej përfitimeve individuale.

Ata mendojnë se besimi është gjëja më e rëndësishme për të angazhuar të tjerët dhe preferojnë të ndjekin nisma me rezultate shumë të prekshme, e në fund bazuar në këto rezultate ose e vazhdojnë aksionin qytetar ose e braktisin. Ata e vlerësojnë gjithë ndihmën që mund të marrin, por mund të ndihen të frikësuar si 'të rinj' në shoqërinë civile. Ata nuk i kuptojnë gjithmonë procedurat e gjata dhe shpesh i shohin ato si mungesë besimi dhe jo si pjesë të vlefshme të një procesi. Ata entuziazohen lehtësisht nga nevoja për të luajtur role të ndryshme të tilla si organizator, zbatues, burokrat, opinionist, zëdhënës, ekspert i çështjes, punonjës administrativ, qytetar kërkues dhe role të tjera të ndërmarra në jetën e tyre private. Ata kërkojnë mbështetje të fortë dhe udhëzime dhe çdo mbështetje tjetër ka vlerë të madhemjetet dhe mediumet e tjera dixhitale.

TABELA 1. INDIVID I RI

PERSONAZHI	INDIVID I RI
KARAKTERISTIKAT	<ul style="list-style-type: none">• KA NJOHURI SHUMË TË MIRA NË NJË FUSHË TË EKSPERTIZËS PROFESIONALE• KA INVESTUAR PERSONALISHT DHE EMOCIONALISHT NË NJË KAUZË<ul style="list-style-type: none">• MOSHA E MESME• KA AFTËSI BAZË DIXHITALE• JETON NË KOMUNITETIN E FUSHËS SË PROJEKTIT
NEVOJAT	<ul style="list-style-type: none">• VETËPËRMBUSHJA<ul style="list-style-type: none">• NJOHJE• SIGURI• LEGJITIMITET• BESUESHMËRI NGA KOMUNITETI• MBËSHTETJE FINANCIARE

³ Historitë e Personazheveve u referohen përfituesve të vërtetë të granteve, megjithatë, emrat janë ndryshuar për qëllime konfidencialiteti.

PERSONAZHI

VENDOSJA E VLERËS

INDIVIDI I RI

- TEMA TË DREJTUARA NGA VEPRIMI
 - MBLEDHJA DHE ORGANIZIMI I INFORMACIONIT
 - RRJETËZIMI
 - MBËSHTETJE PËR AFTËSITË E MENAXHIMIT TË PROJEKTIT
 - MBËSHTETJE FINANCIARE
 - MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE
 - AFTËSITË E RAPORTIMIT
- BURIME TË BESUESHME INFORMACIONI DHE UDHËZIME
 - NDIHMË JURIDIKE E BESUESHME DHE FALAS
 - TË MËSUARIT E MJETEVE TË REJA DIXHITALE DHE MBËSHTETJE PËRKATËSE
 - TË MËSUARIT SI PROCES QË MUND TË PËRSËRITET
- FORMATET E THJESHTA TË THIRRJEVE
 - KRITERE TË THJESHTA PRANUESHMËRIE
 - STIL I THJESHTË DHE MIQËSOR KOMUNIKIMI
- QASJE PJESËMARRËSE E DONATORIT
 - MUNDËSITË PËR VEPRIM PASUES

PERSONAZHI 2



INDIVIDI I QËNDRUESHËM, GENTI⁴

Genti është një i ri energjik, i cili është angazhuar për një kohë të gjatë në aktivizëm dhe në shoqërinë civile. Ai ka pasur sukses në përpjekjet dhe projektet e mëparshme të shoqërisë civile dhe krenohet me arritjet e tij në këtë fushë.

Genti është metodik në qasjen e tij dhe racional në qëndrimin e tij ndaj shqetësimeve të komunitetit në përgjithësi mjetet dhe mediumet e tjera dixhitale. Ai e peshon mirë problemin që duhet zgjidhur dhe çfarë mund të arrihet brenda një periudhe të caktuar kohore.

Ndërkohë që ndjek aktivizmin si profesion, ai përpiqet të përfitojë ekspertizë dhe përvojë në një ose dy fusha problematike, ku mendon se mund të kontribuojë më shumë. Genti priret drejt rezultateve, duke qenë i bindur se rezultatet e prekshme nga komuniteti, i japin atij besueshmëri të trefishtë, me donatorin, me shoqërinë civile dhe me grupet e veçanta të bashkësisë apo grupet e interesit ku ai është aktiv. Ka aftësi shumë të mira në menaxhimin e një projekti dhe artikulon qartë mangësitë për të cilat ka nevojë për ndihmë. Genti sheh vlerë dhe pushtet tek rrjetëzimi, që i krijojnë mundësi për të rritur interesin dhe pse jo për të arritur rezultate më të qëndrueshme. Genti nuk jeton gjithmonë në komunitetin ku realizohet projekti i tij, megjithatë udhëton shumë shpesh dhe ka marrëdhënie të ngushta me njerëzit. Në fakt, ai i vlerëson shumë këto lloj lidhjesh dhe synon t'i forcojë ato më tej.

PROFILI I PERSONAZHIT: INDIVID I QËNDRUESHËM

Individi i qëndrueshëm ka qenë anëtar aktiv i shoqërisë civile për disa vite me radhë. Ata angazhohen me një pjesë të vogël të çështjeve me të cilat ndihen afër dhe kanë një qasje sistematike për zgjidhjen e tyre. Ata janë shumë racionalë, me ide të qarta përsa u përket gjërave që dëshirojnë të arrijnë dhe atyre që janë të arritshme. Individi i qëndrueshëm ndjek aktivizmin si karrierë profesionale dhe për këtë arsye është shumë i organizuar.

Genti shpesh vepron si zëdhënës i komuniteteve të vogla dhe e sheh veten si pikë referimi për to.

Duke vepruar në këtë mënyrë, ai tregohet i kujdesshëm dhe mendje hapur ndaj ndjeshmërive të përbashkëta dhe formimit të ndryshëm të të tjerëve. Kjo e bën atë të mos ketë një qëndrim të prerë, por të tregohet fleksibël ndaj propozimeve për zgjidhje.

Genti është i aftë nga pikëpamja digjitale. Ai përdor çdo ditë mjete dhe kanale digjitale dhe arrin të përshtatet menjëherë me mënyrat e avancuara ose më pak të avancuara të komunikimit. Ai është shumë i ndjeshëm ndaj audiencës, duke u treguar i shkathët dhe krijues në qasjen e tij ndaj zgjidhjeve. Genti ndjen shumë nevojën e përkatësisë në grupin/grupet e afirmuara të shoqërisë civile, si mënyrë për të fuqizuar veten si një agjent ndryshimi. Profili i Gentit si individ që përfshihet rregullisht dhe me kohë të plotë në veprimin qytetar paraqitet në tabelën 2 më poshtë.

Ata synojnë të bëhen të njohur prej donatorëve dhe prej komunitetit të OSHC-ve dhe mendojnë se kjo u jep më shumë besueshmëri në sytë e qeversijes vendore apo institucioneve të tjera. Afirmimi i tyre si aktor i shoqërisë civile varet së tepërmi nga besimi i komunitetit dhe puna e kryer, e për këtë arsye ata shprehin një preferencë të qartë ndaj nismave të bazuara në veprime komunitare, duke theksuar gjithashtu rëndësinë e krijimit të bashkëpunimit me të tjerë aktorë, përmes rrjetëzimit.

⁴ Historitë e Personazheveve u referohen përfituesve të vërtetë të granteve, megjithatë, emrat janë ndryshuar për qëllime konfidencialiteti.

Ata mendojnë se zërat e vetëm, pa mbështetje të strukturuar nuk mund të jenë të qëndrueshëm dhe mund të dëmtojnë angazhimin qytetar në përgjithësi, pasi komunitetet nuk i mirëpresin nismat e përsëritura por pa rezultate, që janë ndërmarrë më parë nga aktorë të tjerë. Individit i qëndrueshëm vlerëson shumë çdo mbështetje ose instrument që i lejon ata të fitojnë vëmendje, veçanërisht rrjetëzimin.

Ata gjithashtu e vlerësojnë SHVSH-në pasi kjo ndihmon natyrën e tyre metodike dhe nevojën e tyre për besueshmëri si me OS-HC-të ashtu edhe me komunitetet. Ata priren të krijojnë marrëdhënie pozitive me qeverisjen vendore dhe institucionet, me qëllim arritjen e rezultateve më të qëndrueshme.

TABELA 2. INDIVID I QËNDRUESHËM

PERSONAZHI	INDIVID I QËNDRUESHËM
KARAKTERISTIKAT	<ul style="list-style-type: none"> • KA NJOHURI SHUMË TË MIRA NË NJË FUSHË TË CAKTUAR BRENDA SHOQËRISË CIVILE • KA INVESTUAR PERSONALISHT NË NJË KAUZË <ul style="list-style-type: none"> • I RI, ENERGJIK • I MIRËORGANIZUAR • KA AFTËSI TË MIRA DIGJITALE <ul style="list-style-type: none"> • KA LIDHJE TË NGUSHTA ME KOMUNITETIN E FUSHËS SË PROJEKTIT
NEVOJAT	<ul style="list-style-type: none"> • ARRITJA E KARRIERËS PROFESIONALE <ul style="list-style-type: none"> • NJOHJA PREJ DONATORËVE • NJOHJA PREJ QEVERISJES VENDORE <ul style="list-style-type: none"> • PËRKATËSIA NË GRUP • LEGJITIMITETI • BESUESHMËRIA NGA KOMUNITETI <ul style="list-style-type: none"> • AFIRMIMI SI AKTOR QYTETAR
VENDOSJA E VLERËS	<ul style="list-style-type: none"> • TEMA TË DREJTUARA NGA VEPRIMI <ul style="list-style-type: none"> • MBLEDHJA DHE ORGANIZIMI I INFORMACIONIT <ul style="list-style-type: none"> • RRJETËZIMI • KRITERE TË THJESHTA PRANUESHMËRIE PËR THIRRJET • SEMINARE TEMATIKE • AFTËSITË E RAPORTIMIT • MBËSHTETJE PËR PUNËN NË TERREN <ul style="list-style-type: none"> • MBËSHTETJE MEDIATIKE • SHËRBIME FALAS SI NDIHMA JURIDIKE <ul style="list-style-type: none"> • PRAKTIKAT E MBIKËQYRJES MIQËSORE

VENDOSJA E VLERËS

- RREGULLA DHE PROCESA TRANSPARENTE
- NDJEKJA E PROJEKTEVE/TRASHËGIMISË

PERSONAZHI 3

GRUPI INFORMAL, JETA⁵

Grupi informal JETA përbëhet nga të rinj shumë të gjallë dhe krijues. Ata janë shumë entuziastë, ndonjëherë idealistë, gjithësi janë shumë të përqendruar në një fushë të veçantë problematike të komunitetit. Ekziston një hierarki e sheshtë brenda grupit dhe drejtimi është me rotacion dhe në marrëveshje të plotë mes anëtarëve. Megjithatë, dalin në pah 3 deri në 4 anëtarë më të spikatur, të cilët drejtojnë veprimtaritë dhe aktivitetet. Këta janë nismëtarët e idesë. Vetëm 1 ose 2 nga drejtuesit e grupit angazhohen me kohë të plotë në veprimtaritë e grupit informal. Pjesa tjetër e anëtarëve kanë angazhime të tjera profesionale, por janë shumë aktivë në angazhimin dhe vullnetarizmin e tyre. Anëtarët e Grupit Informal JETA janë shumë të prerë në mendime dhe mbajnë një qëndrim të qartë në çështjet e komunitetit. Ata janë shumë të hapur dhe këmbëngulës në përmirësimin e mënyrës së jetesës dhe cilësisë së jetës së tyre, familjeve dhe miqve të tyre, në zonën ku jetojnë. Brenda grupit ka shumë diskutime dhe angazhime formale dhe informale. JETA krenohet që ka lidhje të forta me zonën dhe mbeten këmbëngulës në moshpalljen si organizatë politike.

Ata ndihen thellësisht të papërfaqësuar ose të keqpërfaqësuar në vendimmarrjen e qeverisjes (si në qeverisjen vendore, ashtu edhe në atë qendrore) dhe në politikë.

JETA si grup kërkon të gjejë mënyra krijuese për angazhimin, në veçanti për rininë, duke e parë reagimin letargjik të shoqërisë si një problem sistematik dhe kulturor, shkaku kryesor i të cilit lidhet me një ndjesi të përgjithshme të mungesës së shpresës dhe me një sistem të dobët arsimor që nuk promovon as të menduarit kritik, as aktivizmin si të drejta. Megjithatë, JETA është një grup optimist, me të rinj që janë aktualisht në universitet ose në fazat e hershme të jetës së tyre profesionale. Ata janë jokonformistë nga natyra dhe këmbëngulës në përpjekjet e tyre për të ndryshuar gjërat që i rrethojnë.

JETA ndihet e pambrojtur, pasi e konsideron mjedisin jo mikpritës ndaj aktorëve të shoqërisë civile në shumë dimensione, si social, politik apo financiar. Për shkak se ata ndihen përfaqësues të një komuniteti të cenueshëm financiarisht dhe social pranë Tiranës, ata kërkojnë të mbijetojnë falë legjitimitetit të veprimit të tyre dhe jo vetëm të mbështeten në disponueshmërinë e instrumenteve, që ofrohen për ta nga OS-HC-të apo komuniteti i donatorëve.

⁵ Historitë e Personazheve u referohen përfituesve të vërtetë të granteve, megjithatë, emrat janë ndryshuar për qëllime konfidencialiteti.

Anëtarët e JETA janë të organizuar, por kanë nevojë për më shumë aftësi praktike në menaxhimin e projektit, në të shkruar dhe në menaxhimin financiar të veprimtarive të tyre, kur marrin pjesë në nisma të tilla si ajo me LA-në. Ata gjithashtu theksojnë nevojën për të pastur besueshmërinë e komunitetit. Për arritjen e kësaj besueshmërie, ata e konsiderojnë thelbësore bashkëpunimin me OSHC-të, por janë shumë të kujdesshëm të theksojnë se presin prej tyre më tepër një qasje bashkëpunuese, sesa një rol mbikëqyrës.

PROFILI I PERSONAZHIT: GRUPI INFORMAL

Grupi informal përbëhet nga njerëz të rinj dhe shumë energjikë, të cilët tregojnë një lidhje të ngushtë me komunitetin e grupit të interesit. Ata janë shumë aktivë dhe tregojnë lidhje të qartë emocionale me grupin. Ata mund t'i përforcojnë kauzat e tyre dhe mund të ndërmarrin disa nisma në të njëjtën kohë. Arritja e konsensusit mes anëtarëve të grupit e ballafaqon disi Grupin Informal ndaj sfidave për të marrë një miratim sa më të gjerë në komunitet dhe për këtë arsye ata janë shumë të kujdesshëm në shprehjen e natyrës së tyre jopolitike (duke iu referuar politikave partiake). Ata priren të jenë më krijues se sa dy Personazhet e tjerë, duke shprehur cenueshmërinë kolektive të anëtarëve dhe dëshirën për të mbijetuar. Grupi Informal është shumë krenar që është i lidhur me komunitetin dhe tregon interes të veçantë për çdo nismë që mund të përmirësojë cilësinë e jetës dhe mënyrën e jetesës në zonën e tyre.

Përfaqësuesja e JETA është shumë e hapur dhe shumë krijuese në sugjerimet e saj për LA-në dhe organizatat e tjera. Ajo sugjeron që komuniteti i donatorëve dhe organizatat duhet më mirë të përqendrohen tek praktikrat e këqia dhe dështimet si mjet përmirësimi, se sa tek praktikrat më të mira, pasi të parat mund të ofrojnë kontribute më të mëdha dhe njohuri më të vlefshme për atë që në realitet është pengesë për rezultate dhe ndikim. Profili i përgjithshëm i grupeve informale është përmbledhur në Tabelën 3 më poshtë.

Duke pasur më shumë besim, aftësi dhe një gamë të gjerë formimi dhe ekspertize, të ofruar nga anëtarët, Grupi Informal shpreh qartë nevojën për afirmim dhe njohje. Ata duan të shihen si partnerë të veprimit qytetar dhe jo si përfitues grantesh. Si të tillë, ata vlerësojnë shumë nismat e veprimit në komunitet si mjet për të fituar më tej besueshmërinë si aktor të shoqërisë civile brenda komunitetit të tyre, por edhe në marrëdhënie me qeverisjen në nivel vendor apo qendror. Përpyekjet e tyre shpeshherë vijnë përtej qëllimit dhe jetëgjatësisë së zbatimit të projektit të tyre me LA-në dhe kjo është arsyeja pse ata e vlerësojnë në mënyrë të veçantë rrjetëzimin dhe çdo mbështetje në krijimin e bashkëpunimit me organizata të tjera. Ata e vënë theksin në nevojën për të rritur shkallën e veprimit kundër pengesave dhe për krijimin e mundësive për të pasur shtrirje më të gjerë në shkallë kombëtare, duke u bashkuar me aktorë të tjerë vendore.

Megjithatë, ata nuk dëshirojnë të bëhen lojtarë 'kombëtarë'. Ata janë mjaft të vetëdijshëm dhe krenarë që i përkasin komunitet

të tyre të vogël dhe këmbëngulin në rolin e tyre si partnerë me eksperiencë për Shoqërisë Civile brenda zonës së tyre.

TABELA 3. GRUPI INFORMAL

PERSONAZHI	GRUPI INFORMAL
KARAKTERISTIKAT	<ul style="list-style-type: none"> • I RI DHE SHUMË ENERGJIK • SHUMË AKTIV • I PËRQENDRUAR TE FUSHA E PROBLEMIT • LIDHJA PERSONALE DHE EMOCIONALE ME GRUPIN DHE KAUZËN • HIERARKI E SHESHTË • FORMË E CENUESHME E ORGANIZIMIT • PËRSHTATET SHPEJT • SHUMË KRIJUES
NEVOJAT	<ul style="list-style-type: none"> • MBËSHTETJE E THEKSUAR • BESUESHMËRI • NDJENJA E KRENARISË DHE MBËSHTETJES TE VETJA • POHIMI NË GRUP • CILËSIA E STILIT TË JETËS • NJOHJA E KOMUNITETIT • BASHKËPUNËTORË DHE JO MBIKËQYRËS
VENDOSJA E VLERËS	<ul style="list-style-type: none"> • TEMAT E ORIENTUARA NGA VEPRIMI KOMUNITAR • RRJETËZIMI • MEDIATIZIMI • MBLËDHJE DIGJITALE E INFORMACIONIT • QASJE INOVATIVE DHE KRIJUESE NDAJ AKTIVIZIMIT • PRAKTIKA PËRSËRITËSE PËR PROBLEMET E PAZGJIDHURA OSE PJESËRISHT TË ZGJIDHURA • MBËSHTETJE FINANCIARE E VAZHDUESHME (E GËNDRUESHME) • PËRMIRËSIMI I IDEVE TË PROJEKTIT • KOORDINIMI I PËRPYEKJEVE TË PËRFITUESVE TË GRANIT ME FOKUSIT TË NGJASHËM PËR TË MAKSIMIZUAR REZULTATET • PROCESET DHE VLERËSIMET TRANSPARENTE

VENDOSJA E VLERËS

- QASJA PJESEMARRËSE E DONATORIT DHE LA-SË
- NJË NUMËR MË I MADH GRANTESH PËR GRUPET INFORMALE JASHTË TIRANËS
- MË SHUMË SEMINARE MBI FUQIZIMIN

HARTA E PROCESIT DHE MUNDËSUESIT

Siç është përmendur dhe më lart, LevizAlbania ofron mbështetje, nëpërmjet granteve, mentorimit dhe një sërë Shërbimesh me Vlerë të Shtuar (SHVSH) për individët dhe grupet informale për të kontribuar në një numër më të madh të qytetarëve aktivë. Proceset e zhvilluara janë vendosur si praktika dhe procedura standarde që synojnë ta bëjnë gjithë procesin transparent nga fillimi në fund dhe përgjithësisht të realizueshëm drejt qëllimit të përgjithshëm.

Figura II më poshtë paraqet ndërveprimet kryesore midis LA-së dhe përfituesve të grantit. Ndërveprimet kryesore janë ato ngjarje ose veprimtari pa të cilat, Projekti (i individit ose grupit informal) nuk mund të ecë përpara. Këto dokumentohen siç duhet dhe ruhen si prova nga LA-ja dhe nga përfituesi i grantit.



1 NDËRGJEGJËSIMI 2 KONKURSI I IDEVE 3 ZHVILLIMI I PROJEKTIT

- Njoftimi i thirrjes
- Sesione informacioni

- Shkëmbimi i informacioneve
- Përgjigje të drejtpërdrejta për idetë

- Mbështetje për shkrimin e projektit pyetjeve dhe
- Vlerësimi i ideve të projektit



4 PËRGATITJA FORMALE 5 ZBATIMI 6 RAPORTIMI

- Shkëmbimi përfundimtar i përgjigjeve
- Shpallja e projektit fitues
- Nënshkrimi i kontratës

- Njohja dhe informacionet e projektit
- Mbikëqyrja e projektit
- Monitorimi i shërbimeve
- Planifikimi dhe shënime monitoruese

- Provat e raportit përfundimtar
- Planifikimi
- Vlerësimi përfundimtar i hipotezave përmes rezultateve

Nëpërmjet çdo hapi të përshkruar më sipër, LA-ja synon të krijojë dhe të sigurojë një mjedis mbështetës për aktorin qytetar. Intervistat me menaxherët e granteve kanë ndihmuar në krijimin e listës së mëposhtme

të mundësuesve që përfshin instrumentet, veprimet mbështetëse direkte dhe indirekte dhe aktivitetet kryesore të paraqitura së bashku në Tabelën 4 më poshtë.

TABELA 4. MUNDËSUESIT E LA-SË

HAPI KRYESOR PËR NDËRVEPRIM	MUNDËSUESI
NDËRGJEGJËSIMI	<ul style="list-style-type: none"> • NJOFTIM TRANSPARENT I THIRRJES PUBLIKE • TEMA TË QARTA TË THIRRJEVE • KRITERE TË QARTA TË PRANUESHMËRISË PËR APLIKIMET • TEMAT PËRFAQËSUESE TË KOMUNITETIT
KONKURSET E IDEVE	<ul style="list-style-type: none"> • TEMA TË HAPURA DHE TRANSPARENTË TË KONKURIMIT • FORMAT I QARTË DHE I THJESHTË I KONKURIMIT • MEKANIZMI I GRANTIT PËR NISMA TË VOGLA
ZHVILLIMI I PROJEKTIT	<ul style="list-style-type: none"> • MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E IDEVE TË PROJEKTIT • MBËSHTETJE PËR SHKRIMIN E PROJEKTIT • MBËSHTETJE ORGANIZATIVE • TRAJNIM I PËRGJITHSHËM MBI MENAXHIMIN E PROJEKTIT
PËRGATITJA FORMALE	<ul style="list-style-type: none"> • SESION PYETJESH DHE PËRGJIGJESH PËR TË MBËSHTETUR RREGULLIMIN E PARAMETRAVE TË PROJEKTIT • SHPALLJE TRANSPARENTË PËR FITUESIT • PËRGJIGJE TRANSPARENTË PËR IDETË E PROJEKTEVE JOFITUESE • MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE PËR MARRËVESHJET KONTRAKTUALE

<p>ZBATIMI</p>	<ul style="list-style-type: none"> • MBËSHTETJA E PROCESIT DHE NJOHURIVE • MENTORIMI PËR NEVOJA SPECIFIKE <ul style="list-style-type: none"> • RRJETËZIMI • BURIMET E PËRMBLEDHURA DIXHITALE TË INFORMACIONIT • NDIHMË JURIDIKE FALAS • MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE • MBIKËQYRJA E SHËRBIMEVE TË PROJEKTIT • RRJETËZIMI DHE MBËSHTETJA ME EKSPERTË PËR ÇËSHTJET • MBËSHTETJA E MENAXHIMIT FINANCIAR
<p>RAPORTIMI DHE MBYLLJA E PROJEKTIT</p>	<ul style="list-style-type: none"> • MODEL I THJESHTË I FORMATIT • MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE • VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR I HIPOTEZËS PËRMES SHËRBIMEVE DHE REZULTATEVE

Megjithëse tabela e mësipërme e mundësive është gjithëpërfshirëse, ajo nuk arrin të përmbledhë disa elementë që kontribuojnë drejtpërdrejt në mbështetjen e Veprimit Qytetar dhe Aktorëve civilë. Ato do të përfshihen në Seksionin e Vëzhgimeve të këtij dokumenti. Nga ana tjetër, tabela ofron prova për një vlerësim të informuar se si mundësuesit në çdo hap u shërbejnë qëllimeve të qëndrueshmërisë. Për qëllimet e kësaj analize qëndrueshmëria i referohet aftësisë së LA-së për të rritur nivelin e aktivizmit, duke sjellë shtimin e një numri më të madh të qytetarëve aktivë.

Dimensione të tjera të qëndrueshmërisë janë dhënë më sipër në këtë dokument dhe përfshijnë: aftësinë e individit(ve) për t'u grupuar, përshkallëzuar dhe rrjetëzuar brenda një grupi/komuniteti më të madh me një kauzë ose interes të përbashkët; aftësia e një individi ose grupi individësh për të mbështetur përpjekjet dhe aktivitetet e tyre në kohë në ndjekje të një interesi të përbashkët shoqëror; dhe aftësinë e një individi ose grupi për të krijuar një grup njo-hurish dhe përvojash që mund të shërbejnë si kapital social, i cili mund të përsëritet dhe të përmirësohet në ndjekjen e një interesi të përbashkët shoqëror. Aspekte të tjera të qëndrueshmërisë si besueshmëria, llogaridhënia dhe legjitimiteti i aktorit dhe iniciativës do të shikohen në Seksionin e Vëzhgimeve.


KONTRIBUTI DREJT QËNDRUESHMËRISË

Në këtë seksion, çdo hap i Ndërveprim-it është vlerësuar si një mjet për të kontribuar drejt Qëndrueshmërisë së Qytetarisë Aktive siç matet nga dimensionet e përshkruara më sipër. Më specifikisht: Ndërgjegjësimi: Njoftimet transparente të thirrjeve publike dhe kriteret e thjeshta të përshtatshmërisë, të kombinuara me grupe specifike të synuara (individë dhe grupe joformale) ofrojnë mundësi për aktorët e rinj.

Njoftimet e thirrjes për aplikime nuk vendosin kriteret për prejardhjen e individëve ose grupeve joformale të aplikantëve, por përkundrazi përqendrohen në temat dhe veprimet e komunitetit, duke krijuar kështu mundësi për aktorët qytetarë jo-traditionalë.

Për më tepër, temat përkatëse të komunitetit ndihmojnë përfituesit të fitojnë besueshmëri dhe legjitimitet brenda vendndodhjes së tyre të afërt, një fakt që pranohet në mënyrë uniforme nga të gjithë të intervistuarit dhe mbështetet më tej nga rezultatet e anketës online të paraqitur këtu si Figura III.

FIGURA III



BURIMI: ANKETA ONLINE, FQ. 45


KONKURSI I IDEVE:

Vetë konkursi si një ngjarje e hapur i ndihmon përfituesit jo vetëm që të marrin reagime të menjëhershme nga paneli përzgjedhës, por gjithashtu shërben si një kontroll ad hoc për ndikimin e nismës së tyre dhe arritjet që do të ketë. Për më tepër, kur përfituesit e granteve u pyetën nëse kishin ndonjë pjesë të veçantë të përvijës së tyre me LA që u pëlqeu, pa dallim, Konkursi i Ideve ishte përgjigjja e tyre kryesore.

Prandaj mund të argumentohet se ky ndërveprim midis LA-së dhe përfituesve të granteve është motivues i fortë dhe si i tillë, luan rol të rëndësishëm për aplikimet e rradhës. Ky argument shërben për të matur qëndrueshmërinë e aktorëve dhe mbështetet më tej edhe nga anketa online (shih Figurën IV më poshtë) ku më shumë se gjysma e përfituesve të grantit kanë aplikuar tashmë më shumë se një herë në thirrjet e shpallura gjatë viteve nga LA.

FIGURA IV

SA HERË KENI APLIKUAR PËR GRANT NË THIRRJET E PUBLIKUARA NGA LA?



• VETËM NJË HERË • 2-3 HERË • 4-5 HERË • NË TË GJITHA THIRRJET

BURIMI: ANKETA ONLINE, FQ. 5


ZHVILLIMI I PROJEKTIT, PËRGATITJA FORMALE, RAPORTIMI DHE MBYLLJA E PROJEKTIT:

Këto tre ndërveprime ndërmjet LA-së dhe përfituesve të granteve janë të përqendruara shumë në punën administrative. Mentorimi, udhëzimi dhe mbështetja e menaxherëve të granteve të LA-së, gjatë këtyre tre fazave, është e orientuar drejt zhvillimit të aftësive hard si shkrimi dhe planifikimi dhe menaxhimi financiar; si dhe aftësive soft si organizimi, bashkëpunimi dhe lidhësi.

Këto janë edhe më të rëndësishme kur krijohet një strukturë mësimi që është e zbatueshme dhe e ripërsëritshme në iniciativat tjera me të cilat mund të angazhohen aktorët qytetarë dhe si rrjedhim, janë pjesë e rëndësishme e kapitalit social që krijohet. Të dyja intervistat, si e thelluara ashtu dhe anketa online (Figura V më poshtë) konfirmojnë se përfituesit kanë mësuar dhe kanë fituar aftësi të reja, edhe pse natyra dhe shkalla e të mësuarit ndryshojnë dhe do të jenë subjekt i mëtejshëm i analizës në seksionin e Vëzhgimeve.

FIGURA V

A JU SHËRBEJ PËRVOJA E JUAJ SI PËRFITUES I GRANTIT PËR TË MËSUAR DIÇKA TË RE DHE TË VLEFSHME?



• PO • DISI • JO

BURIMI: ANKETA ONLINE, FQ. 33


ZBATIMI I PROJEKTIT:

Ky është padyshim hapi më i rëndësishëm ku ndërveprimet midis LA-së dhe përfituesve të grantit mund të përmirësojnë ose dobësojnë të gjitha dimensionet e qëndrueshmërisë të përmendura më parë. Për këtë arsye, menaxheri i granteve si rregulator i mbështetjes, rrjetëzimit dhe ekspertizës së fushës përkatëse, merr rol vendimtar. Duhet përmendur në këtë kontekst, se intervistat tregojnë marrëdhënie më të thellë dhe më kuptimplote ndërmjet përfituesit dhe menaxherit të grantit në Thirrjet 6 dhe 7 krahasuar me Thirrjet 1-5.

Të gjithë përfituesit e granteve nga Thirrjet e mëvonshme (6 dhe 7) i referohen menaxherit të grantit me emër dhe shprehin qartë se si dhe ku ka ndihmuar saktësisht mentorimi dhe udhëzimi, për të pasur rezultate të prekshme të projektit, për t'u ndjerë një agjent ndryshimi më i fuqishëm dhe për të rritur përpjekjet si pjesë e një rrjeti më të madh. Këto janë kontribute të drejtpërdrejta në të gjitha dimensionet e qëndrueshmërisë, që janë për t'u lavdëruar dhe që mund të përsëriten më tej. Figurat VI, VII dhe VIII nga anketa online ofrojnë dëshmi dhe mbështetje për vlerësimin.

FIGURA VI


A JU KA NDIHMUAR SKEMA E GRANTEVE TË LA-SË PËR TË ARRITUR REZULTATE PËR PROJEKTIN TUAJ?



BURIMI: ANKETA ONLINE, FQ. 25

FIGURA VII


SI JU DUK MBËSHTETJA DHE MENTORIMI I DHËNË NGA LA-SË PËR TË ARRITUR OBJEKTIVAT DHE QËLLIMIN E PROJEKTIT TUAJ?



BURIMI: ANKETA ONLINE, FQ. 31

FIGURA VIII

SA HERË JENI TAKUAR ME STAFIN E LA-SË GJATË ZBATIMIT TË PROJEKTIT TUAJ?



• TË PAKTËN NJË HERË NË JAVË • TË PAKTËN NJË HERË NË MUAJ • NGANJËHERË • PRAKTIKISHT ASNJËHERË

BURIMI: ANKETA ONLINE, FQ. 35

Për më tepër, intervistat e thelluara dhe rezultatet e anketës online dëshmojnë se Shërbimet me Vlerë të Shtuar (SHVSH), të ofruara nga LA-ja vlerësohen nga përfituesit, ku më të dallueshme janë Klinikat e Ligjit. Janë në zbatim edhe SHVSH të tjera, rëndësia dhe përdorimi i të cilave ndryshon shumë nga një përfitues granti tek tjetri.

Portavendore.al duket se është zgjedhja më e njohur dhe më e arsyeshme, duke qenë se natyra e informacionit që ofron është e lidhur drejtpërdrejt me veprimet e qeverisjes vendore, të theksuara në thirrjet e LA-së.

MËSIMET DHE VËZHGIMET

Ky seksion i vlerësimit do të paraqesë mënyrën se si mentorimi, mbështetja dhe SHVSH-të që LA-ja ofron, afrohen apo janë më larg vendosjes së vlerës së Personazheve të përcaktuar më sipër në dokument. Ky është një hap kyç për vlerësimin e përvojës, pasi synon të nxjerrë në pah në mënyrë të qartë rëndësinë specifike të mentorimit, të mbështetjes dhe të SHVSH-ve të LA-së për secilin Personazh brenda kontekstit të tyre. Ato zona ku Personazhet shohin vlerë (këtu e quajtur Vendosje e Vlerës) që plotësohen nga LA-ja, funksionojnë si motivues për aktorët civilë dhe për këtë arsye kontribuojnë në ruajtjen e aktivizmit, ndaj duhet të shihen si me rëndësi parësore dhe të kapitalizohen më tej.

Nga ana tjetër, ato fusha ku LA-ja nuk ofron mbështetje ose i adreson pjesërisht, duhet të mbahen si zona të mundshme përmirësimi për ciklin vijues të thirrjeve dhe praktikave përkatëse.

Tabelat 5, 6 dhe 7 më poshtë japin rëndësinë e Trajnimit, Mbështetjes dhe SHVSH-ve të LA-së për secilin prej Persona-ve të përcaktuara si të sjella nga intervistat e thellura me përfituesit.

TABELA 6. INDIVID I RI

VENDOSJA E VLERËS PËR INDIVIDIN E RI	PRAKTIKA E LA-SË	VERIFIKIMI I TË DYJAVE
TEMAT E DREJTUARA NGA VEPRIMI	TEMAT E VEPRIMIT TË KOMUNITETIT	✓
GRUMBULLIMI DHE ORGANIZIMI I INFORMACIONIT	SHVSH (PORTALET)	✓
RRJETËZIMI	RRJETËZIMI DHE SHVSH	✓
MBËSHTETJE PËR MENAXHIMIN E PROJEKTIT	TRAJNIMI I MENAXHIMIT TË PROJEKTIT	✓
MBËSHTETJE FINANCIARE	SKEMA E GRANTEVE	✓
MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE	MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE	✓
MBËSHTETJE PËR AFTËSITË E RAPORTIMIT	TRAJNIM	✓
BURIME TË BESUESHME INFORMACIONI DHE UDHËZIMESH	SHVSH DHE TRAJNIM	✓
NDIHMË JURIDIKE FALAS	SHVSH (KLINIKA E LIGJIT)	✓
MËSIMI I MJETEVE TË REJA DIGJITALE DHE AFTËSIVE DIGJITALE	N/A	✗

VENDOSJA E VLERËS PËR INDIVIDIN E RI	PRAKTIKA E LA-SË	VERIFIKIMI I TË DYJAVE
FORMAT I THJESHTË I THIRRJES	FORMAT I THJESHTË I THIRRJES	✓
KRITERE TË THJESHTA PRANUESHMËRIE	THIRRJET E HAPURA	✓
STIL I THJESHTË DHE MIQËSOR KOMUNIKIMI	GRANT MBËSHTETJE PËR MENAXHERIN	✓
QASJA PJESËMARRËSE E DONATORIT	MBIKËQYRJA E PROJEKTIT	✗
MUNDËSITË PËR VAZHDIM	DISA PROJEKTE JANË ZGJEDHUR PËR T'U RRITUR	PJESËRISHT

Siç sugjerojnë rezultatet në Tabelë, praktika e LA-së plotëson shumicën e fushave ku Personazhi Individ i Ri sheh dhe kërkon vlerë. Vlerat kryesore të përmendura në intervista përfshijnë thjeshtësinë e thirrjeve dhe kriteret jokufizuese të pranueshmërisë, mbështetjen e gjerë dhe ndihmesën për menaxhimin administrativ dhe atë të projektit gjatë zbatimit të tij, mbështetjen financiare dhe marrëdhënie empatike me menaxherin e grantit. Për më tepër, dy fusha të rëndësishme ku duket se ka njëfarë shkëputjeje midis asaj ku Individ i Ri sheh vlerë dhe ku praktika e LA-së ka nevojë për përmirësim, përfshijnë qasje më pjesëmarrëse të donatorit dhe mundësi për vazhdim. Për të qenë më specifik, Individ i Ri sheh më shumë vlerë në një marrëdhënie të bazuar në partneritet me LA-në, ku kjo e fundit është më pak e përfshirë në rolin e rreptë të mbikëqyrjes dhe matjes së performancës, si një mënyrë për të aprovuar ose mos aprovuar aktorin qytetar.

Në të kundërt, Individ i Ri mendon se LA-ja si mundësues, duhet të fokusohet në mësimin e natyrës së pengesave dhe të sigurohet që rezultatet të arrihen edhe pas mbylljes së projektit. Procedurat e gjata burokratike të njësive të qeverisjes vendore, shumë shpesh e shtyjnë zbatimin e projektit përtej afateve, duke shkaktuar arritje të pjesshme të rezultateve të prekshme ose me përgjigje formale pozitive nga NJQV-të, por pa veprim konkret. Meqenëse Individ i Ri është shumë i etur për të fituar besueshmëri brenda komunitetit të tij, është thelbësore për të që të ketë produkte dhe rezultate të prekshme. Kjo do të luante një rol të madh për qëndrueshmërinë e tij si një “hero social” i besueshëm.

TABELA 7. INDIVIDU I QËNDRUESHËM

VENDOSJA E VLERËS PËR INDIVIDIN E QËNDRUESHËM	PRAKTIKA E LA-SË	VERIFIKIMI I TË DYJAVE
TEMAT E DREJTUARA NGA VEPRIMI	TEMAT E VEPRIMIT TË KOMUNITETIT	✓
GRUMBULLIMI DHE ORGANIZIMI I INFORMACIONIT	SHVSH (PORTALET)	✓
RRJETËZIMI	RRJETËZIMI DHE SHVSH	✓
MBËSHTETJE FINANCIARE	SKEMA E GRANTEVE	✓
MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE	MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE	✓
MBËSHTETJE TEMATIKE	MBËSHTETJE UNIVERSALE	✗
MBËSHTETJE PËR PUNËN NË TERREN	RRJETËZIMI DHE SHVSH	✓
MBËSHTETJE MEDIATIKE	RRJETËZIMI DHE SHVSH	✓
FORMAT I THJESHTË I THIRRJES	FORMAT I THJESHTË I THIRRJES	✓
NDIHMË JURIDIKE FALAS	SHVSH (KLINIKA JURIDIKE)	✓
PRAKTIKA MIQËSORE TË MBIKËQYRJES	MBIKËQYRJA E PROJEKTIT	PJESËRISHT
THIRRJET NË VAZHDIM/VAZHDIMËSIA	DISA PROJEKTE JANË ZGJEDHUR PËR T'U RRIUR	✗

Individi i Qëndrueshëm, ndryshe nga Individi i Ri sheh më pak vlerë në ndihmesën e tepruar për menaxhimin e projektit, pasi ata janë të pajisur me aftësi të tilla. Për ta është më e rëndësishme të marrin mbështetje për tema specifike ku iu mungon ekspertiza e lëndës dhe në ato fusha ku ata dëshirojnë të rrisin njohuritë e tyre. Shpesh këto tema përfshijnë fusha dhe qasje të reja të politikave, reforma specifike, praktika për të rinjtë dhe/ose grupet e marginalizuara. Seancat e informimit i interesojnë më pak Individit të Qëndrueshëm, pasi ato duket se nuk shtojnë ndonjë vlerë të veçantë. Dy fusha kyçe që Personazhet Individë të Qëndrueshëm theksojnë në intervista përfshijnë Rrjetëzimin dhe një lloj Vazhdimësie për Veprimin/Nismën e tyre.

Ndërsa LA-ja ofron mundësi të shumta për rrjetëzim, praktikën për të përshkallëzuar projekte të spikatura apo kriteret e vendosura që lejojnë përfituesit e mëparshëm të grantit të marrin pjesë në thirrje të njëpasnjëshme jo domosdoshmërisht përputhen me vendosjen e vlerës së Individit të Qëndrueshëm për të vijuar më tej veprimin e tij. Ata shprehen se është e rëndësishme të mbështetje e vazhdueshme për nismat dhe kjo ndonjëherë është më e rëndësishme se qëndrueshmëria e vetë Aktorit Civil.

TABELA 8. GRUPI INFORMAL

VENDOSJA E VLERËS PËR GRUPIN INFORMAL	PRAKTIKA E LA-SË	VERIFIKIMI I TË DYJAVE
TEMAT E DREJTUARA NGA VEPRIMI	TEMAT E VEPRIMIT TË KOMUNITETIT	✓
MBLEDHJA E INFORMACIONIT NË MËNYRË DIGJITALE	SHVSH (PORTALET)	✓
RRJETËZIMI	RRJETËZIMI DHE SHVSH	✓
MBËSHTETJA E VAZHDUESHME FINANCIARE	SKEMA E GRANTEVE	✓
MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE	MBËSHTETJE ADMINISTRATIVE	✓
QASJE INOVATIVE DHE KRIJUESE	QASJA E LA ËSHTË INOVATIVE	PJESËRISHT
PRAKTIKA PËRSËRITËSE PËR PROBLEMET E PAZGJIDHURA	DISA PROJEKTE JANË ZGJEDHUR PËR T'U PËRSHKALLËZUAR	✗
MEDIATIZIMI	RRJETËZIMI DHE SHVSH	✓
PËRMIRËSIMI I IDEVE TË PROJEKTIT	DISA PROJEKTE JANË ZGJEDHUR PËR T'U PËRSHKALLËZUAR	✓
NDIHMË JURIDIKE FALAS	SHVSH (KLINIKA E LIGJIT)	✓
QASJA E LA-SË DHE DONATORËVE ME PJESËMARRJE	MBIKËQYRJA E PROJEKTIT	PJESËRISHT
PROCESET DHE VLERËSIMET TRANSPARENTE	PROCESET TRANSPARENTE	✓
PËRPIEKJET E KOORDINUARA TË PËRFITUESVE ME FOKUS TË NGJASHËM PËR TË ARRITUR REZULTATE MAKSIMALE	RRJETËZIMI	PJESËRISHT
NJË NUMËR MË I MADH GRANTESH JASHTË TIRANËS	SHPËRNDARJA GJEOGRAFIKE E GRANTEVE ËSHTË SIPAS RASTIT	PJESËRISHT

Grupi Informal është shumë i ndryshëm nga dy personazhet e tjerë për sa i përket vendosjes së vlerës. Struktura e tyre organizative pothuajse formale çon në një vlerësim shumë më të lartë për fushat e mbështetjes që i mundësojnë organizatës të rritet dhe të përmirësohet.

Kjo është arsyeja pse ata e vlerësojnë mbështetjen e dhënë për Rrjetëzim, thirrjet për nisma në komunitet, platformat e besueshme të informacionit, mediatizimin e çështjeve dhe qasjet novatore/krijuese ndaj angazhimit qytetar.

Hapësirat mes praktikave të ndjekura nga LA dhe vendosjes së vlerës nga personazhet Grup Informal janë të arsyeshme, sepse praktikat e LA-së nuk bëjnë dallime midis këtyre Personazheve dhe janë universale për të gjitha grupet e synuara. Grupi informal është Personazh më këmbëngulës për praktikën pjesëmarrëse të donatorit dhe kërkon më pak mbikëqyrje nga LA. Argumenti mbizotërues është se ekziston rreziku i mbiformalizimit të rolit të aktorëve të shoqërisë civile, gjë që çon në dhënien e një rëndësie më të ulët cilësisë së veprimit dhe rezultateve të prekshme, duke vlerësuar nga ana tjetër si më të rëndësishme ofrimin e dëshmimeve lidhur me zhvillimin e aktiviteteve. Grupi Informal gjithashtu nënvizon mundësitë e humbura për të rritur shkallën e veprimit qytetar brenda kohës së zbatimit të projektit, sepse praktikat e rrjetëzimit nuk përputhen me përkufizimin e tyre të saktë të vendosjes së vlerës.

KATEGORITË E PRAKTIKËS

Intervistat me përfituesit e granteve kanë dhënë informacion dhe njohuri të shumta. Ndërkohë që kanë vlerësim të përgjithshëm pozitiv të përvojës së tyre me LA-në, përfituesit e granteve shprehin mendime të përziera kur vjen fjala tek qëndrueshmëria dhe dimensionet e saj. Këto janë ndarë në dy kategori kryesore të praktikave, të Dëshirueshme dhe jo të Dëshirueshme/kufizuese të cilat drejtpërdrejtë ose tërthorazi ndikojnë tek qëndrueshmëria, në një ose më shumë mënyra

Ata besojnë se kur përfituesit e granteve me fusha të ngjashme punojnë së bashku (pavarësisht territorit), ndoshta edhe duke plotësuar njëri-tjetrin, në vend që të punojnë si agjentë të veçuar të ndryshimit, ndikimi që sjellin është më i madh. Së fundi, Grupi Informal tërheq vëmendjen për rritjen e pranisë dhe veprimit të aktorëve qytetarë dhe veprimit qytetar jashtë qytetit të Tiranës. Argumenti i paraqitur është se asimetritë ekonomike, politike dhe shoqërore mes Tiranës dhe pjesës tjetër të vendit shoqërohen edhe në numrin dhe rolin e aktorëve të shoqërisë civile. Prandaj, do të ishte e arsyeshme që të luftoheshin asimetritë ekzistuese dhe jo ti përforconim.

PRAKTIKAT E DËSHIRUESHME

Përfituesit e vlerësojnë së tepërmi qasjen novatore të LA-së për të përfshirë individët dhe grupet informale si aplikantë të pranueshëm në Thirrjet që publikojnë. Ata mendojnë se, veçanërisht me skepticismin që ekziston ndaj OSHC-ve, këto veprime e sjellin shoqërinë civile në një fillim të ri, më afër nevojave të qytetarëve dhe ndihmojnë aktorët e rinj të shoqërisë civile të fitojnë besueshmëri dhe legjitimitet. Përfituesit gjithashtu vlerësojnë plotësisht proceset dhe procedurat transparente. Një pikë kyçe, e përmendur unanimisht, është Konkursi i Ideve që ata e pëlqejnë veçanërisht, një fakt që zgjon nevojën e fjetur për të qenë krijuar në angazhimin qytetar.

Pabarazitë që ekzistojnë mes Tiranës dhe pjesës tjetër të vendit theksohen gjatë bisedave me përfituesit. Ata theksojnë rëndësinë e krijimit dhe mbështetjes së aktorëve dhe nismave qytetare në zonat ku autoritetet vendore nuk u përgjigjen ose u përgjigjen pak nevojave të bashkësive dhe ku frenimet e tjera kulturore kufizojnë shtrirjen, fuqinë dhe qëndrueshmërinë e angazhimit dhe veprimit qytetar. Në të vërtetë, rritja e numrit të granteve individuale dhe të grupeve informale, veçanërisht jashtë Tiranës është sugjerimi më i shpeshtë edhe nga të anketuarit në anketën online.

Përfituesit, veçanërisht nga thirrjet më të fundit për aplikime, shpesh shprehin një ndjenjë mirënjohjeje ndaj menaxherit të grantit, gjë që flet për një marrëdhënie mbështetëse të ndërtuar midis LA-së dhe aktorit të shoqërisë civile. Kjo gjë vihet re më shpesh me individët sesa me grupet informale, pasi individët janë edhe më të cenueshëm dhe më të kufizuar në aftësitë dhe kapacitetet e tyre për të marrë përsipër një sërë rolesh, gjatë fazës së zbatimit të ideve të tyre.

PRAKTIKAT KUFIZUESE

Me gjithë sa u përmend më sipër, përfituesit e grantit vënë në dukje disa fusha për përmirësim. Siç u tha më lart, pavarësisht vlerësimit të qëndrimit të ri të LA-së ndaj individëve dhe grupeve informale, të intervistuarit theksojnë domosdoshmërinë e rritjes së numrit të granteve për këto dy grupe. Një mjet mbështetës i vetëm nuk mjafton për të mbështetur veprimin e individit në veçanti.

Trajnimi në terren është vënë në dukje si më i vlefshëm, në krahasim me seminarët standarde; dhe qasja e *të mësuarit* duke vepruar shihet si më e përshtatshme. Kjo trajtohet më tej në seksionin Gjetjet dhe Rekomandimet.

Të gjithë përfituesit janë të vetëdijshëm për kufijtë dhe kufizimet që vijnë nga të qenit një “hero social” i vetëm ose një grup informal. Ata shprehin mjaft qartë për vlerën që shohin në rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me grupet e tjera të interesit, OSHC-të si dhe me përfitues të tjerë. Kjo i lejon ata drejtpërdrejt të përmirësojnë mënyrën se si i komunikojnë mesazht dhe të fitojnë besueshmëri të mëtejshme si me komunitetet që përfaqësojnë ashtu edhe me NJQV-të. Pothuajse në të gjitha bisedat, Klinikat e Ligjit mbizotërojnë si kontribuues irëndësishëm, ndërsa vlerësohen edhe bashkëpunëtorët e tjerë nga media, shoqëria civile dhe ekspertë të fushës. Së bashku ata i shtojnë rezultatit përfundimtar të një projekti një ndjenjë arritjeje dhe afirmimi, të cilat nga ana tjetër ndikojnë në qëndrueshmërinë e nismës, të aktorit civil dhe potencialit të tij për të rritur veprimtarinë.

Një nga faktorët më të përhapur, i cili ndikon drejtpërdrejt negativisht në qëndrueshmërinë e aktorit qytetar dhe të iniciativës, është mungesa e një mekanizmi pasues. Pasojat janë më thelbësore kur, në mbylljen e projektit, ka ende rezultate të pazgjithura/në pritje. Personazhet Individ i Ri dhe Individ i Qëndrueshëm pothuajse kurrë nuk i ndjekin përpjekjet e tyre përtej jetëgjatësisë së zbatimit të projektit, sepse atyre u mungon mbështetja dhe burimet financiare dhe jofinanciare për ta bërë këtë.

Prandaj, besueshmëria, llogaridhënia dhe legjitimiteti i tyre në komunitet si një “hero social” në zhvillim, vihen në pikëpyetje për përpjekjet e ardhshme në hapësirën e shoqërisë civile. Nga ana tjetër, Grupet Informale priren të vazhdojnë përpjekjet e tyre përtej jetëgjatësisë së grantit, ose si meritë e vullnetarizmit të anëtarëve të tyre, ose sepse janë në gjendje të gjejnë mbështetje shtesë nga burime të tjera.

Të ashtuquajturat “Aksione Komunitare” (Drejtimi 3 në Thirrjet 6 dhe 7) janë të mirëvlerësuara; megjithatë, përfituesit e grantit theksojnë se koha dhe energjia e shpenzuar për burokracitë e projekteve të tyre është e tepërt, duke tejkaluar shpesh atë që kërkohet për të prodhuar rezultate të prekshme për komunitetin. Një shembull specifik u vu re në takimin përmbyllës të projektit të një Personazhi Individ i Ri. Përfituesi i grantit, përpara se të hapte takimin, duhej të sigurohej për plotësimin e listëprezencës së pjesëmarrësve, për publikimin e ngjarjes në Facebook, duhej të fotografonte, të drejtonte dhe njëkohësisht të mbante shënim diskutimet mes përfaqësuesve të qeverisjes vendore, ekspertëve të fushës dhe anëtarëve të komunitetit që ishin të pranishëm, duhej të përmbledhonte dhe zyrtarizonte rezultatet e arritura dhe çështjet në pritje, duhej të siguronte konsensus në diskutim dhe me shkrim për hapat e ardhshëm, të sigurohej për shërbimin e pijeve freskuese për të pranishmit, të sigurohej për faturat e shpenzimeve dhe në fund të shënonte edhe disa reflektime që nevojiteshin për raportin.


Pavarësisht nga diskutimet e shumta dhe angazhimin e gjithë të pranishmëve në takim, menaxhimi vetëm nga një njeri i gjithçkaje ishte shpërqëndruar për të gjithë dhe e lodhshme për përfituesin e grantit. Sigurimi i provave për zhvillimin e takimit u bë më i rëndësishëm se angazhimi për rezultatin përfundimtar.

Për më tepër, edhe planet më rigorozë ndeshen shpesh me sfida për shkak të dinamikave në nivel vendor apo kombëtar, duke i çuar përfituesit e granteve drejt zgjidhjeve ad hoc për hir të ruajtjes së përputhshmërisë me projektin. Përfituesit e granteve sugjerojnë më tej që, ndërsa fokusohen në sigurimin e provave të shumta për rezultatet e projektit, ata hasin në cinizmin e ndonjëherë edhe frikën e pjesëmarrësve në aktivitete, veçanërisht të atyre që nuk dëshirojnë të dokumentohet prania e tyre. Së bashku, këto përvoja shpesh mund t'i mposhtin Individët (veçanërisht Personazhet Individ i Ri) dhe si rezultat, nisma e parë është edhe e fundit për ta. Rezultatet e Anketës Online, të paraqitura si Figura X më poshtë, konfirmojnë raste të tilla dhe kërkojnë një reflektim.

Një aspekt tjetër që kërkon vëmendje është shuma e mbështetjes financiare për këto dy grupe. Edhe pse projektet janë të një shkalle të vogël, një individ nuk është në gjendje të bëjë gjithçka vetëm. Kjo nënkupton kontraktimin e një sërë aktiviteteve, duke pasurkufizime buxhetore në dukje. Këtu dalin qartë dy implikime. Së pari, Personazhi Individ i Ri shpesh nënvlerëson buxhetin, pasi i mungon përvoja dhe llogarit jo saktë përpjekjet e nevojshme për zbatimin e projektit. Së dyti, ndryshimet e rëndësishme midis çmimeve formale dhe informale e përballin personazhin Individ i Ri me shërbime më të shtrenjta, duke prodhuar kështu dokumentacionin e kërkuar në kurriz të pamjaftueshmërive të një buxheti jo efikas, pamjaftueshmëri të cilat janë të rëndësishme në rastin e skemave të mbështetjes financiare në shkallë të vogël. Një pikë e fundit lidhet me shprehjen e përbashkët të interesit të përfituesve të grantit për një qasje më empatike nga LA-ja në vend të një roli mbikëqyrës procedural të projektit. Ata përmendin gjithashtu se do të dëshironin që SDC të merrte pjesë në aktiviteteve të tyre si një mënyrë për të vënë në dukje disa sfida që nuk janë kapur përmes dëshmimeve dhe raporteve. Siç përshkruhet më sipër në dokument, Individët dhe Grupet Informale nga thirrjet më të fundit (6 dhe 7) tregojnë një marrëdhënie dhe partneritet më të ngushtë me menaxherin e grantit, por ata përsëri tregojnë një prirje për të parë vlerë më të lartë nga LA-ja në rolin e një partneri të Shoqërisë Civile dhe më pak si mbikëqyrës i zbatimit të projektit.

FIGURA X

A MENDONI SE DO TË APLIKONI SËRISH NË THIRRJET E NISURA NGA LA-JA NË TË ARDHMEN?



BURIMI: ANKETA ONLINE, FQ. 39

GJETJET DHE REKOMANDIMET

Intervistat me të gjitha palët e interesuara kanë ofruar një pamje 360 gradë të përvojave dhe ndërveprimeve ndërmjet Partnerëve të Konsorciumit, LA-së, Individëve dhe Grupeve Informale.

PËR TU VAZHDUAR...

- Të synuarit drejt individëve dhe grupeve informale përmes skemave të granteve të vogla kontribuon në krijimin dhe mbështetjen e aktorëve civilë që fitojnë besimin e komuniteteve lokale.

- Temat e drejtuara për nga veprimi i komunitetit kontribuojnë drejtpërdrejtë në rritjen e legjitimitetit, llogaridhënies dhe besueshmërisë së aktorëve civilë brenda zonës së tyre ose grupit të interesit, por edhe brenda komunitetit më të gjerë të OSHC-ve.

- Konkursi i ideve, proceset dhe praktikat e tjera transparente të LA-së i motivojnë aktorët civilë potencialë dhe ekzistues që t'u besojnë OSHC-ve dhe t'i shtojnë integritet të mëtejshëm LA-së si instrument, Konsorciumit të LA-së dhe donatorit.

- Mbulimi gjeografik i thirrjeve të LA-së adreson nevojën për zëra dhe kërkesa të reja nga komuniteti, si dhe përfaqësimin më të mirë dhe me vërtetësi të gamës së gjerë të kërkesave që ekzistojnë jashtë Tiranës.

Thellimi në vlerësimin e përvojës së përfituesve të granteve sjell gjetjet dhe rekomandimet e mëposhtme si praktika/shkëmbime ekzistuese dhe të mundshme që ndikojnë në qëndrueshmërinë e angazhimit të qytetarëve përmes mekanizmit të grantit në zbatim.

- Trajnimi dhe mbështetja përmes Rrjetëzimit dhe SHVSH-ve të tjera mundëson aktorëve civilë të mësojnë, zhvillohen dhe shumëfishojnë përpjekjet e tyre drejtpërdrejt dhe tërthorazi duke kontribuar drejt qëndrueshmërisë si të aktorëve ashtu dhe nismave.

- Ndërtimi i marrëdhënieve pozitive mes menaxherëve të granteve dhe përfituesve të granteve i inkurajon këta të fundit që të përdorin më mirë mbështetjen, trajnimin dhe SHVSH, duke çuar në individë dhe grupe informale më të formuara dhe të fuqizuara.

- SHVSH-të janë një burim i pasur mbështetjeje dhe ekspertize. Ato përdoren gjerësisht dhe vlerësohen nga përfituesit. SHVSH-ja kontribuon për të mundësuar rolin e Aktorit Civil dhe shtrirjen e nismave të tij/saj.

TË RISHIKOHET...

- Një qasje më empatike ndaj aktorëve civilë i bën këta të fundit të ndihen të fuqizuar, prandaj LA-ja mund të eksplorojë mënyra për të qenë të pranishëm pa theksuar rolin si mbikëqyrës. Një rekomandim është që të ketë dy takime me përfituesit e grantit të LA-së; një para zbatimit të projektit për të krijuar pritshmëri realiste midis të gjitha palëve dhe për të nxitur një ndjenjë empatie dhe partneriteti⁶. Një takim i dytë do të ishte shumë i vlefshëm për të diskutuar arritjet dhe mangësitë si një seancë reflektuese mes të gjithëve për mësimet e nxjerra. Nga kjo do të përfitonin të gjitha palët me një kurbë mësimi dhe kapitalizimin e mundshëm të përvojës. Megjithatë, është thelbësore që këto takime të marrin formën e diskutimit dhe jo atë të vlerësimit të projekteve sipas shkallës së arritjeve.

- Diferencimi ndërmjet Personazheve si grupe të synuara me karakteristika specifike duhet të shërbejë për të dalluar edhe mjetet për mbështetjen e tyre. Dy opsione u diskutuan me stafin e LA-së. Të dyja alternativat u pranuan si të dëshirueshme, por jo plotësisht të realizueshme. Një opsion do të ishte që të kishte rregulla, procedura dhe dokumentacion më tolerant për Individët (të Rinj dhe të Qëndrueshëm). Një qasje e prirur drejt rezultateve, që fokusohet në provat për rezultatin përfundimtar (veprimet e ndërmarra nga ana e NJQV-së), në vend të dëshmimeve konkrete për secilin prej aktiviteteve dhe rezultateve, do të nxiste më tej një numër më të madh aktorësh të rinj qytetarë dhe një numër më të madh të atyre që vijojnë të mbeten të tillë edhe përtej jetës së një projekti.

Për më tepër, aktorët civilë do të fokusoheshin më shumë drejt rezultateve të prekshme sesa të prodhonin dëshmi fizike të shpenzimeve të projektit. Një opsion i dytë do të ishte të kishim një ekip brenda LA-së që siguron në mënyrë specifike provat/dokumentat për Individët. Ata mund të marrin pjesë në aktivitete, të kujdesen për faturimin, të bëjnë dokumentet dhe të bëjnë foto dhe video, duke e lënë aktorin qytetar të angazhohet plotësisht në rolin e tij për të angazhuar komunitetin dhe për të ndjekur kërkesat e tyre ndaj NJQV-ve. Duke pasur parasysh numrin e kufizuar të Personazheve Individë për thirrje, një numër minimal prej 2 punonjësish të LA-së do të ishte me vlerë të konsiderueshme dhe të mjaftueshëm.

- Koordinimi ndërmjet individëve dhe grupeve informale që ndjekin nisma të ngjashme ose plotësuese do të sillte një efekt shumëfishues dhe do të krijonte sinergji dhe mësimet pozitive. Duke pasur parasysh që LA-ja organizon një sërë sesionesh informuese me përfituesit e grantit, mund të shtohet një seksion i shkurtër ku diskutohen dhe zyrtarizohen sinergjitë e mundshme ndërmjet përfituesve të grantit. Përveç kësaj, LA-ja mund të ndajë me përfituesit e granteve OSHC të tjera të njohura brenda zonës së tyre të interesit, të cilat mund të shtojnë vlerë.

- Seminaret dhe sesionet informuese duhet të bëjnë dallimin midis përfituesve periodikë, ose më me përvojë të granteve dhe atyre të rinj. Ndonëse nuk ka vlerë të shtuar për ata që kanë qenë pjesë e këtyre

⁶ LA-ja përmes menaxherëve të granteve dhe financave tashmë kanë një seancë fillestare orientuese me përfituesit e granteve (kolektivë) për të vendosur pritshmëritë në fillim të projekteve, por është fokusuar edhe në pritshmërinë procedurale dhe vendosjen e mënyrave të bashkëpunimit dhe "rregullave".

aktiviteteve më parë, ekziston rreziku që përfituesit e rinj të ndihen jo rehat dhe të frikësuar. Prandaj rekomandohet që të ndahen seminarët dhe sesionet e informacionit midis Individëve të Rinj dhe pjesës tjetër të Personazheve dhe të rifreskohet

TË FILLOHET...

- Zhvillimi i një mekanizmi pasues që i lejon aktorët qytetarë të ndjekin më tej me rezultatet e pazgjidhura ose pjesërisht të zgjidhura. Kjo do të kontribuojë në të gjitha dimensionet e qëndrueshmërisë. Një rekomandim do të ishte të studiohen projektet ku përfituesit e granteve kanë pasur rezultate të pjesshme ose të dështuara dhe t'i adresojnë ato në një Thirrje të dedikuar çdo dy - tre raunde ose në fund të jetëgjatësisë së zbatimit të projektit të LA-së. Adresimi i pengesave specifike mund të prodhojë të njëjtin efekt (madje edhe më të mirë) drejt qëndrueshmërisë së nismave. Një rekomandim shtesë është të lidhen Personazhet Individë në rrjet me OSHC-të që veprojnë në zonën e tyre të interesit gjatë ose në fund të projektit të tyre. Për shembull, dikush që ndjek nismat e veprimit në komunitet që kanë të bëjnë me sigurinë e grave, mund të ndjekë më tej kauzën e tyre me organizatat e njohura të grave në vend. Po kështu, ato nisma komunitare që kanë të bëjnë me mjedisin mund të rrisin përpjekjet e tyre përmes angazhimit me Organizatat e Mbrojtjes së Mjedisit, etj.

- Qasjet inovative/kreative ndaj aktivizmit vlerësohen shumë. Çdo eksplorim në këtë zonë do të stimulojë angazhimin veçanërisht të të rinjve. Gjatë fazës së zhvillimit të projektit, praktikat më të mira nga vende të tjera mund të diskutohen dhe hulumtohen veçanërisht duke u fokusuar në

përmbajtja bazuar në vendosjen e vlerës së sugjeruar në tabelat e mësipërme. Kjo do ta bënte punën e LA-së më efektive dhe efikase për të kontribuar aty ku Personazhet shohin vlerë dhe jo një rrjedhë të rregullt procedurale.

angazhimin digjital, i cili ka treguar rezultate të jashtëzakonshme ndërkombëtare (siç është p.sh. Lëvizja #Me2).

- Të gjithë përfituesit përdorin burime digjitale informacioni, disa më shumë se të tjerët. Megjithatë, ata nuk janë të gjithë përdorues të mirë të tyre. Çdo mbështetje ndaj këtyre aftësive do të kontribuojë në krijimin e Aktorëve Civilë që kuptojnë, nxisin dhe flasin gjuhën e të lindurve në epokën digjitale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur synohen segmentet rinore për aktivizim dhe angazhim qytetar. Diferencimi i përmbajtjes në sesionet informuese dhe seminarët siç sugjerohet më sipër, do të çojë në orientime dhe trajnime më të rëndësishme dhe në një aktor civil të aftë.

VËREJTJE TË FUNDIT

Përvojat e aktorëve qytetarë nën këtë vlerësim janë të larmishme. Disa janë të rinj në aktivizëm, disa të tjerë më të spirovuar, por të gjithë ndërmarrin hapa të vegjël drejt ndryshimit për veten dhe komunitetet ose grupet e tyre të interesit. Konteksti i trazuar politik, ekonomik dhe social i Shqipërisë paraqet sfida serioze për shoqërinë civile në përgjithësi, aq më tepër për anëtarët më vulnerabël si individët dhe grupet informale. Këta të fundit nuk posedojnë burimet dhe kapacitetet që kanë organizatat më të njohura formale. Si të tillë, ata janë më të ekspozuar ndaj dështimit të veprimit dhe shpesh luftojnë për të mbijetuar. Megjithatë, individët dhe organizatat kanë diçka që është shumë e vlefshme. Interesat e tyre bazuar në komunitet, lidhjet e këtij të fundit dhe iniciativat e drejtuara nga veprimet nxisin të tjerët si ata, me të cilët ndajnë të njëjtat shqetësime, telashe dhe probleme dhe kërkojnë zgjidhje të vogla por kuptimplote.

Nuk ka asnjë formulë magjike, e cila siguron që një "hero social" i sapokrijuar, ose një grup aktivistësh premtues të rrisë mbështetjen, të arrijë rezultatet dhe t'i nxisë të tjerët në vazhdimësi. Megjithatë, një vlerësim i përvojës së tyre si qytetarë të angazhuar dhe angazhues hedh dritë mbi atë që motivon, ushqen dhe pengon rolin dhe ndikimin e tyre më pas. Intervistat me individë dhe grupe informale tregojnë për një gamë të gjerë nxitësish. Si përmbledhje përfundimtare, 5 nxitësit që sillen nga përfituesit e intervistuar të grantit si të rëndësishme për procesin dhe modelin e vlerës që LA-ja ofron përmes skemave të granteve dhe trajnimit përfshijnë sa vijon:

- Së pari, përmes zgjerimit të skemës aktuale në numrin e granteve të disponueshme për thirrjet pasardhëse, LA-ja do të jetë në gjendje të ndikojë drejtpërdrejt në një farë mase një numër më të madh të qytetarëve aktivë. Ndjekja e zonave të synuara jashtë Tiranës, ka të ngjarë të prodhojë efekte afatgjata për angazhimin e qytetarëve në shkallë kombëtare.

- Së dyti, trajnimi dhe mbështetja e vazhdueshme, veçanërisht kur ofrohet në terren dhe rafinohet më tej sipas nevojave dhe vendosjes së vlerës së secilit Personazh, siç sugjerohet më sipër, zhvillon individin kompetencat kolektive, e kreativitetin dhe ka shumë të ngjarë të sjellë një nivel të ri në efikasitetin e granteve, rezultate më të prekshme për komunitetin dhe përfundimisht legjitimitet dhe besueshmëri për Aktorët Civilë në nivel vendor.

- Së treti, çdo kontribut i ngjashëm me Klinikat e Ligjit dhe Portën Vendore do të rrisin më tej cilësinë e projekteve dhe integritetin e rezultateve të tyre. Një rekomandim do të ishte krijimi i një strukture të ngjashme për OSHC-të ku informacioni i grumbulluar mbi nismat, fushat e politikave dhe aktivitetet të përfshihet në një platformë dhe t'u ofrojë të gjithë aktorëve të rinj ose ekzistues qytetarë të interesuar, një dritare informacioni të besueshëm, mundësi rrjetëzimi, histori suksesi që mund të ndiqet dhe të përsëritet, Njohja dhe promovimi i shembujve të angazhimit të qytetarëve është i rëndësishëm, por jo i mjaftueshëm.

Prandaj, një faktor i katërt kyç i qëndrueshmërisë është të ushqejë më tej një mjedis mbështetës ku OSHC-të janë partnerë të aktorëve civilë (që janë në zhvillim dhe të cenueshëm) në vend që të jenë mbikëqyrës për aktivitetet e tyre. Rekomandimet për të sheshuar hierarkinë dhe për të rritur numrin e shkëmbimeve ndërmjet përfituesve, LA-së dhe SDC, të përmendura në seksionin e Gjetjeve, do të promovojnë një mjedis nxitës për aktorët e rinj civilë. Ata tashmë kërkojnë ndryshim të niveleve të autoritetit të shprehura nga NJQV-të, ndaj shtimi i një shtrese tjetër autoriteti mbi rolin e tyre si agjent ndryshimi nuk mund të shërbejë si shtysë drejt rritjes së angazhimit qytetar.

- Kontributi i fundit dhe ndoshta më i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e individëve dhe grupeve informale është një mekanizëm pasues pas përfundimit të projekteve, sepse ai nënkupton qëndrueshmërinë si një proces dhe jo si një hap dhe nxit një mjedis shumë të rëndësishëm për të inkurajuar dhe siguruar qëndrueshmërinë e angazhimit qytetar. Prandaj rekomandohet shumë që një hap i parë drejt këtij qëllimi të bëhet të paktën një herë brenda Fazës II të LevizAlbania.



REFERENCAT DHE BIBLIOGRAFIA

Blerjana Bino, Orkidea Xhaferaj, Lutojona Lula:

The role of CSO and Media in Crisis Management in Albania.

https://www.wfd.org/wp-content/uploads/2020/12/Role-of-CSO_Media_Crises_WFD_Bino_Xhaferaj_Lula-1.pdf

Dario Castiglione, Jan W. VanDeth, Guglielmo Wolleb (ed). (2008).

The handbook of social capital.

Oxford, Oxford University Press.

DLDP Raport Studimor:

Monitorimi i Parë i Strategjisë së Decentralizimit.

<https://portavendore.al/wp-content/uploads/2018/04/Raport-Studimor-DLDP-Monitorim-i-I-Strategjia-Decentralizimit-te-QV-2016-1.pdf>

Ezio Manzini. (2015)

Design, when everybody designs: an introduction to design for social innovation.

Londër: The MIT Press.

IDM Opinion Poll

Trust in Governance 2020

<https://idmalbania.org/public-opinion-poll-trust-in-governance-2020/>

JRC Scientific and Technical Reports:

“The characterization of Active Citizenship in Europe”

<https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/70bfbae0-9f79-4c52-898d-4cf3d58c819b>

McKinsey.

Design thinking handbook

OECD:

How's life 2020, Measuring Well-being, Civic Engagement

https://read.oecd-ilibrary.org/economics/how-s-life-2020_2797cfd9-en#page1

Open Government Partnership.

Independent Reporting Mechanism (IRM): Albania Transitional Results Report 2018-2020

[Albania_Transitional-Results-Report_2018-2020_EN](#)

Swiss Cooperation and Development Agency

Swiss Cooperation Strategy Albania 2018-2021

Swiss Cooperation and Development Agency, Consortium of Partners

Project Description Alb.

Viktor Papanek.(2006)

Design for the real-world human ecology and social change.

London:Thames & Hudson.